

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“AMOS-GOLD” SH.P.K.**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar **AMOS-GOLD SH.P.K.** Me ortak të vetem: **Z. Aldon Kuraj**, shtetësia shqiptare, lindur në Elbasan më 30.12.1991, banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i ID me Nr J11230061L

**NENI 1**  
**EMËRTIMI**

Shoqëria është themeluar në 08/08/2023 me emërtimin “**AMOS-GOLD**” SH.P.K.

**NENI 2**  
**SELIA**

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë TIRANË Njesia Bashkiake nr 9, Rruga Xhorxh Bush, Zona kadastrale 8150 Numri i pasurisë 6/67 Vila 1 Hyrja 1 Asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të vendosë krijimin ose mbylljen e selive dytësore, filialeve, zyrave të përfaqësimit dhe degëve të shoqërisë ose transferimin e selisë së shoqërisë në qytete të tjera si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

Vendbanimi i ortakëve për të gjitha marrëdhëniet me shoqërinë është ai që rezulton nga akti i themelimit ose nga njoftimet e mëvonshme të tyre dërguar pranë selisë së shoqërisë.

**NENI 3**  
**OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:  
Tregeti ,shitje, blerje flori dhe argjend

**NENI 4**  
**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar. Afati mund të zgjatet, një ose disa here, nga asambleja e ortakëve me vendimin e shumicës për modifikimin e statutit.

**NENI 5**  
**KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100.000 leke (njqind mije) dhe zotërohet plotësisht nga Ortaku i vetëm i saj. Ky kapital është i ndarë në 1 kuote me të njëjten vlerë prej 100 000 lekë të cilat zotërohen nga ortaku i vetëm i shoqërisë : **Z. Aldon Kuraj**.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve përkatëse të Asamblesë së përgjithshme të ortakëve të marra me shumicat e parashikuara nga ligji për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6

### KALIMI I KUOTAVE

Pjesët e kapitalit themeltar janë nominative dhe të ndashme sipas ligjit. Të drejtat, përfshirë edhe e drejta e votës, u takojnë ortakëve në përpjestim me kuotat që secili zotëron në kapitalin themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Në rastin e kalimit të kuotave në favor të të tretëve, ortakëve të tjerë të shoqërisë u takon e drejta e parablerjes. Ortaku që dëshiron të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, kuotat e pjesëmarrjes së tij në shoqëri duhet t'ju komunikojë ortakëve të tjerë nëpërmjet letrë rekomande, ofertën e marrë, duke treguar emrin e blerësit dhe kushtet e tjetërsimit, në mënyrë të veçantë çmimin e caktuar dhe modalitetet e pagesës. Ortaku/ortakët e interesuar, brenda njëzetë ditëve nga marrja dijeni, duhet t'i komunikojnë ortakut që tjetëron të drejtat, nëpërmjet letrë rekomande, interesin për të ushtruar të drejtën e parablerjes, duke përfshirë, eventualisht, edhe interesin për blerjen e pjesës së kuotave për të cilën nuk është ushtruar e drejta e parablerjes nga ana e ortakëve të tjerë. Është i pavlefshëm çdo njoftim që nuk përmban të gjithë të dhënat e mësipërme.

Në rast se asnjë prej personave që kanë të drejtën e parablerjes nuk mund ose nuk dëshiron ta ushtrojë atë, e drejta që u takon zmadhohet automatikisht dhe përpjestimisht në favor të ortakëve të tjerë që kanë shprehur interesin e tyre në ushtrimin e kësaj të drejte. Në rast se disa ortakë, që marrin ofertën, ushtrojnë të drejtën e parablerjes, kuotat do të ndahen ndërmjet tyre në përpjestim me pjesët respektive të kapitalit themeltar që zotërojnë.

Në rast se në letrën e komunikimit tregohet një person një bën pjesë në shoqëri, edhe këtij të fundit i përket e drejta e parablerjes krahas ortakëve të tjerë. E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet për të gjithë pjesëmarrjen e ofruar, pasi i tillë është objekti i propozimit të formuluar nga ortaku ofrues. Parablerja duhet të ushtrohet për çmimin e përcaktuar nga ofruesi.

Nëse parablerja nuk ushtrohet brenda afateve të treguara më sipër dhe për tërësinë e pjesëmarrjes së ofruar, ortaku ofrues mund t'i transferojë kuotat e veta në favor të blerësit të treguar në komunikim dhe në kushtet e parashikuara në të, pasi të ketë marrë pëlqimin paraprak të ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e kapitalit themeltar.

Pëlqimi i ortakëve mund të mohohet nëse blerësi i propozuar ndodhet në njërin nga kushtet si më poshtë:

- është dënuar për një vepër penale me vendim gjyqësor, edhe nëse nuk ka marrë ende formën e prerë;
- i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, ka falimentuar, ose është dënuar me një dënim plotësues që sjell ndalimin, edhe të përkohshëm, të së drejtës për të ushtruar funksione publike ose detyra drejtuese pranë personave juridikë;
- në momentin e transferimit të pjesëmarrjes, nuk merr përsipër detyrimin kundrejt shoqërisë të kryejë shërbimet aksesore për të cilat detyrohej ortaku shitës;
- ushtron, për llogari të vet ose të dikujt tjetër një veprimtari konkurruese me atë të shoqërisë.

Në rast se pëlqimi i ortakëve mohohet gjithsesi, edhe jashtë rasteve të parashikuara më lart, ortaku gëzon të drejtën e largimit nga shoqëria, sipas afateve dhe modaliteteve të parashikuara nga neni 101 i Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ("*Ligji Tregtar*").

Në rastin e vdekjes së njërit prej ortakëve, trashëgimtarët mund të bëhen ortakë të shoqërisë vetëm me pëlqimin e ortakëve të mbetur, që vendosin, me shumicën e kapitalit themeltar, nëse tu lejojnë trashëgimtarëve të fitojnë të drejtat e kuotës së trashëguar apo nëse t'ua likuidojnë pjesëmarrjen në të holla..

#### **NENI 7**

##### **VENDIMET E ASAMBLESË SË ORTAKËVE**

Asambleja e përgjithshme e ortakëve vendos mbi çështjet që i rezervohen kompetencës së saj nga ligji dhe nga ky Statut .

Asambleja e përgjithshme e ortakëve vendos me 51% (pesëdhjetë e njëpër qind) të votave te ortakeve pjesemarres në lidhje me të gjitha çështjet që nuk kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 9 të këtij statuti. Ne kete rast ortakët pjesemarres duhet te perfaqesojne me shume se 30% te kuotave te shoqerise.

#### **ART. 8**

##### **MBLEDHJA E ORTAKUT TË VETËM**

Në rast së kuotat e kapitalit themeltar zotërohen tërësisht nga një ortak i vetëm do të zbatohen dispozitat e posaçme të Ligjit Tregtar, si dhe dispozitat e këtij statuti për sa janë të aplikueshme për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm.

#### **ART. 9**

##### **VENDIMET ME SHUMICË TË KUALIFIKUAR**

Asambleja e përgjithshme e ortakëve vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesemarres mbi ndryshimet e këtij Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në asnjë rast, shumica nuk mund të detyrojë ndonjë prej ortakëve të zmadhojë angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

#### **NENI 10**

##### **THIRRJA E ASAMBLESË SË ORTAKËVE**

Asambleja e përgjithshme e ortakëve e thirrur në mënyrë të rregullt përfaqëson tërësinë e ortakëve dhe vendimet e saj, të marra konform ligjit dhe këtij statuti, janë të detyrueshme për të gjithë ortakët, edhe nëse këta mungojnë ose nuk janë të të njëjtit mendim.

Asambleja thirret nga administratori nëpërmjet njoftimi me shkresë dërguar në vendbanimin e ortakëve, të paktën 7 (shtatë) ditë para datës së mbledhjes së asamblesë. Asambleja mund të thirret edhe nëpërmjet postës elektronike.

Në njoftimin e thirrjes duhet të tregohen vendi, dita dhe ora e mbledhjes dhe lista e çështjeve që do të trajtohen. Në mungesë të formaliteteve të mësipërme, asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë në thirrje.

Ortakët kanë të drejtën e pjesëmarrjes në asamble dhe gëzojnë të drejtën e votës në përpjestim me pjesëmarrjen e secilit prej tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Vendimet e asamblesë së përgjithshme të ortakëve duhet të regjistrohen në procesverbalin e nënshkruar nga kryetari dhe mbajtësi i procesverbali

## NENI 11

### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Organi administrativ i shoqërise është administratori i vetem : **Z. Aldon Kuraj** i cili do të qëndrojë në detyrë për një periudhë prej 5 (pese) vitesh me të drejtë rizgjedhje, nga data 08.08.2023 – 08.08.2028.

Administratorët qëndrojnë në detyrë për periudhën e caktuar nga ortakët në momentin e emërimit ose, në mungesë përcaktimi, deri në dorëheqjen ose shkarkimin e tyre dhe mund të rizgjidhen.

Nuk mund të emërohen në detyrën e administratorit dhe, nëse janë emëruar, duhet të shkarkohen, personat të cilëve u është hequr ose kufizuar aftësia për të vepruar, kanë falimentuar ose u është ndaluar, edhe përkohësisht, e drejta për të ushtruar funksione publike ose detyra drejtuese pranë personave juridikë, si rrjedhojë e një vendimi penal.

Në rast emërimi për një afat të caktuar, detyra e tyre përfundon në datën e asamblesë së thirrur për miratimin e bilancit të vitit të fundit ushtrimor të mandatit të tyre.

Përfundimi i mandatit të administratorit për shkak të përfundimit të afatit ka efekt nga momenti i riformimit të organit administrativ.

## NENI 12

### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

Administratorët kanë të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm të shoqërisë, në përputhje me sa është parashikuar nga ligji, nga akti i themelimit dhe nga ky statut. Ata gëzojnë të drejta dhe fuqi të plota për kryerjen e çdo veprimi që vlerësojnë të dobishëm për realizimin e objektivave të shoqërisë, me përjashtim të atyre që duhet të merren me vendim të Asamblesë së përgjithshme të ortakëve. Në mënyrë të vecantë, hyjnë në kompetencat e organit administrativ veprimtaritë e mëposhtme :

- a) Hartimi i inventarit, llogarive vjetore dhe raportit me shkrim mbi administrimin, në mbylljen e çdo viti financiar;
- b) Hartimi i projekteve të bashkimit dhe ndarjes së shoqërisë;
- c) Propozimi për celjen apo mbylljen e degëve, filialeve, zyrave të përfaqësimit të shoqërisë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- d) Përgatitja e relacioneve mbi marrëveshjet e mundshme të realizuara ndërmjet shoqërisë dhe një prej administratorëve ose ortakëve të saj.
- e) Mbikqyrja e veprimtarisë së drejtorit të pikave të shitjes dhe të punësuarve të shoqërisë.

Në rastin e disa administratorëve, secili prej tyre mund të ushtrojë veçmas të gjitha veprimet për administrimin e zakonshëm të shoqërisë.

Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posacëm për kryerjen e akteve të vecanta ose të një kategorie aktesh, duke përcaktuar kompetencat përkatëse.

Në rast kundërshtimi të njërit prej administratorëve ndaj akteve që synon të kryejë një tjetër, kompetenca për të vendosur mbi kundërshtimin i përket Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 13**  
**PËRFAQËSIMI**

Administratoret ushtrojnë te vetëm përfaqësimin e përgjithshëm të shoqërisë kundrejt të tretëve dhe në gjykim. Ata mund të caktojnë avokatë dhe përfaqësues të shoqërisë përpara organeve gjyqësore, organeve të administratës shtetërore dhe të tretëve, si dhe përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose kategori aktesh.

**NENI 14**  
**VITI USHTRIMOR DHE BILANCI**

Viti ushtrimor mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.

Në fund të çdo viti ushtrimor, organi administrativ procedon me hartimin e bilancit të vitit ushtrimor, brenda afateve dhe në përputhje me dispozitat e ligjit.

Dokumentat e kontabilitetit, të shoqëruar, nëse e nevojshme, nga raporti i ekspertëve kontabël të autorizuar duhet tu komunikohen dhe tu vihen në dispozicion ortakëve pranë selisë së shoqërisë të paktën pesëmbëdhjetë ditë përpara datës së Asamblesë.

**NENI 15**  
**FINANCIMI I ORTAKËVE**

Shoqëria mund të marrë nga ortakët kontribute në të holla dhe hua, me ose pa kamatë, në përputhje me dispozitat në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Dhënia e këtyre financimeve nga ana e ortakëve është e lirë.

**NENI 16**  
**PRISHJA E SHOQËRISË**

Prishja e shoqërisë vendoset nga Asambleja e përgjithshme e ortakëve me shumicat e parashikuara për ndryshimin e këtij statuti për një nga shkaqet e mëposhtme:

- 1) përfundim të afatit;
- 2) pamundësi të funksionimit ose mosfunksionim të vazhdueshëm të asamblesë;
- 3) me vendim të asamblesë së ortakëve;
- 4) për shkaqe të tjera të parashikuara me ligj.

**NENI 17**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë dhe që ka objekt të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


**NENI 18**

**LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut do të disiplinohet nga dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, për sa të aplikueshme.

**ORTAKU I VETEM**

**Z. Aldon Kuraj**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Aldon Kuraj', is written over the printed name. The signature is stylized and cursive, with a large initial 'A' and a long horizontal stroke extending to the right.